



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM

Për Shtesë Në Rendin E Ditës Në Mbledhjen e Radhës

Në mbështetje të nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49 , neni 55 pika 5, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, neni 5 “Vendimmarrja nga Organet Kolegjiale,, Këshilli Bashkiak Durrës,

NJOFTON:

DITËN E PREMTE, DATË 30.10.2020, ORA 12:00, NË MBLEDHJEN E RRADHËS QË DO TË MBAJ KËSHILLI NËPËRMJET MJETEVE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK, DO TË KEMI SHTESA (SHTOHEN 3 PIKA) NË RENDIN E DITËS SI MË POSHTË:

| **** | MIRATIMI I SHTESAVE TË RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES |
|--|--|
| Pika 14. Shqyrtim dhe miratim i projekt- vendimit | PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 1’910’159 LEKË PËR FAMILJET E DËMTUARA SI REZULTAT I DËMIT TË SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR E OBJEKTEVE/ NDËRTESAVE NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1, 2 DHE NR. 5, TË LISTËS EMËRORE TË PËRFITUESVE DHE DËRGIMIN E SAJ PRANË MINISTRISË SË RINDËRTIMIT PËR DHËNIEN E FONDIT |
| Pika 15. Shqyrtim dhe miratim i | PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1, 4, 5, 6, RRASHBULL DHE SUKTH, BASHKIA DURRËS |

| | |
|--|---|
| projekt-vendimit | |
| Pika 16. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit | PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE, SIPAS LISTËS SË SHTATË ME SUBJEKTET PËRFITUES TË PROGRAMIT TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019 |

Në mbështetje të nenit 5 të Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020, të nenit 33 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e **Komisionit të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin elektronikisht projektvendimin përkatës, dërgojnë me email propozimin e tyre (RAPORTIN) mbi projektvendimin sipas grafikut të mëposhtëm.**

DATA 29.10.2020 Pika 14, do të shqyrtohet nga:

- a. Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave
- b. Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë

DATA 30.10.2020 Pikat 15, do të shqyrtohen nga:

- a. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
- b. Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës
- c. Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike

DATA 30.10.2020 Pika 16, do të shqyrtohet nga:

- a. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
- b. Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Dorina Milja